



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA  
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government  
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije  
Ministry of Finance  
Arkivo - Arhiva - Archive

Org. Unit: 02/MAPL  
Pr. Prot. No.: 386-1/2022  
Data Datum Date: 23/03/2022  
No. pages: 2  
PRISHTINE/A

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -  
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

Për:	<b>Bali Muharremaj</b> , Kryetari i Komunës së Suharekës <b>Bexhet Kuçi</b> , Kryesues i Kuvendit të Komunës
Kopje:	<b>Elbert Krasniqi</b> , Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal <b>Venera Çerkini</b> , Zv. Sekretare e Përgjithshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Njësia për Administrimin e Dokumenteve, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes:	<b>Hekuran Murati</b> , Ministër në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve <b>Enis Spahiu</b> , Zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Nga:	<b>Klit Shala</b> , Zv. Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Zyrtarët përgjegjës:	<b>Elmedina Bajgora</b> , Zv. Udhëheqëse e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit, të Mbështetjes Ligjore dhe të Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve <b>Kimete Zekaj</b> , Zyrtare e Lartë për Politika Buxhetore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Suharekës
Lloji i aktit:	<b>Vendim</b>

I nderuari Kryetar z. Muharremaj,  
I nderuari Kryesues z. Kuçi,

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë, të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive,

plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (QËK) Nr. 04/2021, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-05 për Vetëqeverisje Lokale, aktin komunal si në vijim:

<i>Vendim Nr. 016-12176 për pagesën e shujtës për të gjithë nëpunësit në administratën e Komunës</i>
<i>I miratuar më datë 28.02.2022</i>
<i>I parashtruar për shqyrtim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal më datë 01.03.2022</i>
<i>I dërguar për shqyrtim në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve më datë 08.03.2022</i>

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (këtej e tutje referuar si “**Ministria**”), pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të mësipërm të Komunës së Suharekës, jep konstatimet ligjore të mëposhtme:

1. Komuna e Suharekës, me anë të aktit që është subjekt i shqyrtimit, ka synuar lejimin e pagesës së shujtës për nëpunësit në administratën e Komunës së Suharekës përmes kategorisë së shpenzimeve *mallra dhe shërbime*.
2. Si pikë e parë, dhe për qëllime të këtij vlerësimi është me rëndësi të theksohet se neni 12 i Ligjit Nr. 08/L-066 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022 (këtej e tutje referuar si ‘**Ligji**’) i precizon limitet në shpenzime për organizatat buxhetore.
3. Për të konkretizuar konstatimin e mësipërm, si dhe tregues i rëndësishëm për të vlerësuar limitet në shpenzime në kuptim të shujtave mbetet neni 12, paragrafi 6 i Ligjit, ku përcaktohet se:

*‘Shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar për pagesën e punonjësve, qoftë në formë të shtesave apo si kontribute në mall, përfshirë këtu shujtat apo dhuratat, duke përjashtuar rimbursimin apo shpenzimet e lejuara për udhëtimet jashtë vendit, sipas legjislacionit përkatës.’*

4. Nëse elaborohet vlerësimi ligjor krahas frymës së paragrafit 6 të nenit 12 të Ligjit, evidentohet se shpenzimi i parave publike nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime nuk është i lejuar, qoftë edhe në formë të shujtave.
5. Rrjedhimisht, konform interpretimit të kësaj dispozite, Ministria vlerëson se akti i Komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe për pasojë, Komunës së Suharekës i pamundësohet realizimi i masës së përcaktuar në aktin komunal.

Marrë për bazë konstatimet e mësipërme, Ministria kërkon nga Komuna e Suharekës ndërmarrjen e veprimeve konkrete, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit, në mënyrë që masa e përcaktuar me aktin e komunës të harmonizohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Ministria mbetet në dispozicion të Komunës së Suharekës dhe/apo Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.

Me respekt!

*\*\*Interpretimi i dhënë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përkitazi me këtë çështje mbështetet vetëm në këndvështrimet që prekin fushëveprimin legjislativ të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve\*\**